

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë besoj se ia vlen të fokusohemi sot në diskutimin për ratifikimin e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, sepse në fund të fundit janë tregues konkretë jo thjesht për vullnetin politik, por njëkohësisht për të gjitha mekanizmat e bashkëpunimit financiar, të cilat kërkojnë të arrijnë vetëm rezultate, qoftë edhe në këtë bashkëpunim rajonal. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit për programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014-2020” është një marrëveshje e rëndësishme e mbështetjes financiare që kontribuon për zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe rrit bashkëpunimin midis dy vendeve tona nëpërmjet veprimeve dhe masave të përbashkëta. Mbështetja kryesore financiare e Bashkimit European për prioritetet e vendosura për vendin tonë, ashtu si edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet instrumenteve të asistencës së paraanëtarësimit, si IPA 1, IPA II apo edhe së fundi, IPA III, kanë mbështetur realizimin e rekomandimeve kryesore për përmbushjen e objektivave sipas të gjithë kapitujve. Vlera e programit të kësaj marrëveshjeje prej 1,8 milionë eurosh, duke përfshirë edhe bashkëfinancimin e të dyja vendeve, që parashikohet në këtë marrëveshje për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, do të krijojë mundësinë e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe eksperiencave nëpërmjet përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale apo edhe atyre lokale për sa i përket zonës së programit.

Vetëm për periudhën 2014 - 2020 në fushën e bashkëpunimit rajonal janë konkluduar tashmë gjashtë marrëveshje financimi ndërmjet vendit tonë, Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit European për të njëjtin program, me vlerën 11 900 000 euro. Nga kjo marrëveshje që ne do të ratifikojmë sot do të përfitojnë qarku i Dibrës, Elbasanit, Korçës dhe respektivisht tri rajone në Maqedoninë e Veriut. Programet kryesore që do të përfitojnë nga kjo mbështetje qytetarët e këtyre qarqeve janë në nxitjen e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, rritjen e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve, në mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimaterike, si dhe parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut. Njëkohësisht, asistenca teknike për periudhën e zbatimit të të gjithë programit do të jetë mbështetje për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e strukturave kombëtare, por, njëkohësisht, edhe atyre në nivel lokal apo teknik. Nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje financiare, si dhe bashkëpunimeve të tjera në fusha të ndryshme do të mundësojmë zbatimin e

marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të përbashkëta edhe në të ardhmen midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, duke u mundësuar në këtë mënyrë edhe aktorëve rajonalë dhe vendorë të të dyja vendeve të shkëmbejnë eksperiencat, por, njëkohësisht, edhe të arrijnë rezultate të dukshme dhe me një efekt të matshëm për të gjithë sektorët. Programi i bashkëpunimit midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë ka reflektuar rëndësinë që Bashkimi European u ka kushtuar çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si dhe krijimin e partneriteteve ndërkufitare, autorësinë vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimin e mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cënueshme, pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtjen e mjedisit e të tjera.

Marrëveshja vjen jo vetëm në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit, por edhe në përputhje me legjislacionin e Bashkimit European. Përtej vendimmarrjes së Këshillit të vendeve të Bashkimit European për çeljen e bisedimeve teknike për negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, kjo marrëveshje dhe bashkëpunime të tilla u shërbejnë politikave të integritit në Bashkimin European të vendeve tona, si dhe ndihmojnë në ndërtimin e urave të bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimit të politikave për fqinjësinë e mirë. Prioritet i të gjithëve ne për vitin 2022 është hapja e bisedimeve për procesin e negociatave të integritit european për Shqipërinë me mbajtjen sa më parë të Konferencës së Parë Ndërqeveritare dhe avancimin e tyre në bazë të metodologjisë së re të procesit të negociimit me Bashkimin European, si dhe të zbatimit të MSAsë. Një punë tejet voluminoze do të duhet të kryhet në drejtim të intensifikimit të procesit të harmonizimit të legjislacionit me acqui-n e Bashkimit European. Njëkohësisht, plani kombëtar për integrimin european, që përmban të gjitha aktet që do të duhet të përafrohen vit pas viti, do të jetë në monitorim të vazhdueshëm edhe nga Kuvendi për matjen e arritjeve dhe adresimin e çdo boshllëku ligjor, me qëllim ngushtimin e të gjitha hendeqeve me legjislacionin e Bashkimit European, si edhe do të monitorohet zbatimi i rezultateve të marrëveshjeve si kjo që do të ratifikojmë sot.

Jam e bindur se nëpërmjet këtij ratifikimi do të forcojmë edhe më tej marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut, vend me të cilin na ka bashkuar jo vetëm fqinjësia e mirë, por edhe rrugëtimi i përbashkët në procesin e integritit european. Faleminderit!